



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS SKENDERAJ

Numri i lëndës: 2022:246962

Datë: 14.03.2024

Numri i dokumentit: 05453663

**C.nr.417/2022**

**GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË DEGA NË SKENDERAJ**, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, me gjyqtarin Hajrullah Aruqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësve N.Th.H., Q.I., R.Z., R.Rr. dhe R.Th. të gjithë nga Skenderaj, të cilët i përfaqëson me autorizim Q.R. avokat në Skenderaj, kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi ligjor E.Ç., për kompensimin e inflacionit në pagë, duke vendosur lidhur me lejueshmërinë e marrëveshjes së lidhur në mes të palëve ndërgjyqjese në procedurën e ndërmjetësimit, jashtë seancës gjyqësore, me datë 14.03.2024, jep këtë:

**A K T V E N D I M**

**I. APROVOHET MARRËVESHJA JASHTËGJYQËSORE** me nr. të referencës së Ndërmjetësimit ND.66/2024 e datës 05.02.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësuesit N.O. dhe bashke ndërmjetësuesit F.O., në mes të paditësve N.Th.H., Q.I., R.Z., R.Rr. dhe R.Th. të gjithë nga Skenderaj të cilët i përfaqësoi me autorizim Q.R. avokat në Skenderaj dhe të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria për Arsim të cilën e përfaqësoi përfaqësuesi ligjor E.Ç., me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë.

**II.** Pjesë përbërëse e këtij Aktvendimi është Marrëveshja e Ndërmjetësimit ND.66/2024, e datës 05.02.2024, e cila e ka fuqinë e titullit ekzekutiv.

**A r s y e t i m**

Paditësit në këtë gjykatë përmes të autorizuarit të tyre ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna Skenderaj – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e inflacionit në pagë, në të cilën kanë theksuar se paditësi janë në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër detyrimit të të paditurës nuk e ka realizuar kompensimin e inflacionit në pagë. Tutje ka pohuar se edhe pse i është drejtuar me kërkesë të paditurës për përmbushjen e obligimit, nga e paditura nuk ka marrë përgjigje, andaj ka kërkuar mbrojtje gjyqësore nga gjykata duke kërkuar që të detyrohet e paditura që paditësve në emër të kompensimit të inflacionit në pagë të iu paguaj detyrimin dhe e i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

E paditura me datë 04.01.2024 i ka dorëzuar gjykatës një parashtrësë përmes së cilës ka kërkuar nga gjykata që këtë çështje juridike kontestimore ta referojë në procedurë të ndërmjetësimit, duke i propozuar gjykatës që për këtë të njoftohen paditësit.

Me datë 07.02.2024 gjykata ka pranuar marrëveshjen e ndërmjetësimit me nr. ND.66/2024 të dt.05.02.2024.

Gjykata me rastin e shqyrtimit të marrëveshjes se ndërmjetësimit me nr. të referencës ND.66/2024, të datës 05.02.2024 e lidhur në Zyrën për Ndërmjetësim të ndërmjetësuesit N.O. dhe bashke ndërmjetësuesit F.O., në mes të paditësve dhe të paditurës, me objekt të kontestit kompensimin e inflacionit në pagë, (për më tepër sikurse në marrëveshjen e datës 05.02.2024, pjesë e shkresave të lëndës), vlerëson se kjo marrëveshje i plotëson kushtet ligjore, pasi që kjo gjykatë ka konstatuar se e njëjta nuk është lidhur në kundërshtim me Ligjin dhe për këtë arsye bazuar edhe në dispozitat ligjore të nenit 411 dhe 412 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, lidhur me nenin 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 10, 11, 12, 14, 15 paragrafi 1 të Ligjit për Ndërmjetësimin me nr. 06/L-009, erdhi në përfundim se marrëveshja jashtëgjyqësore ND.nr.66/2024 e datës 05.02.2024 duhet të miratohet dhe si e tillë e njëjta e ka fuqinë e titullit përmbarues.

Nga sa u tha më lartë, u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA NË SKENDERAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM**  
**C.nr.417/2022 me datë 14.03.2024**

**Gjyqtari**  
**Hajrullah Aruqi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.